

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Bazat e Auditimit të
Brendshëm
Internal Audit Basics**

B2

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 06/02/2021

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

1. Fushëveprimi i vlerësimit të jashtëm, të veprimtarisë së një auditimi të brendshëm, NUK duhet të kufizohet në cilën nga opsionet e cekura më poshtë (Standardi 1312) ?
 - A. Shërbimet e sigurimit.
 - B. Shërbimet e këshillimit.
 - C. Praktikrat drejtuese.
 - D. Programin e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë.**
2. Hartat e sigurisë janë një teknikë e cila mundëson një paraqitje vizuale të veprimtarive të sigurisë pasi ato zbatohen për një grup specifik të rreziqeve ose kërkesave të pajtueshmërisë me të cilat përballet një organizatë. Cila nga opsionet e më poshtme ndikon në nevojën për krijimin e hartave të sigurisë?
 - A. Menaxherët e rrezikut.
 - B. Anëtarët e Bordit.**
 - C. Audituesit e brendshëm.
 - D. Praktikuesit e pajtueshmërisë.
3. Akti i shpërndarjes së informacionit të pafavorshëm nga auditori i brendshëm tek organet qeverisëse ose autoritet tjetër jashtë organizatës quhet:
 - A. Sinjalizim i brendshëm.
 - B. Sinjalizim i jashtëm.**
 - C. Zyrtarë publikë ose ombudsperson.
 - D. Raport me qëllim të veçantë.
4. Drejtori i auditimit, bazuar në një raport ose informacion ekzistues të organizatës, mund të bëjë cilën nga veprimet e mëposhtme për ta bërë raportin të përshtatshëm për shpërndarje jashtë organizatës?
 - A. Merr parasysh sinjalizimin e brendshëm.
 - B. Merr parasysh sinjalizimin e jashtëm.
 - C. Informoj zyrtarët publikë ose ombudsmanin.
 - D. Lëshoj një raport me qëllim të veçantë.**
5. Gjatë punës së tyre, auditorët e brendshëm duhet të jenë vigjilentë për mashtrim dhe forma të tjera të krimit të 'jakës së bardhë'. Karakteristikë e rëndësishme që dallon mashtrimin nga llojet e tjera të krimit të 'jakës së bardhë' është se:
 - A. Mashtrimi përfshin një varg parregullsish dhe veprimesh të paligjshme që përfshijnë mashtrim të qëllimshëm.**
 - B. Ndryshe nga krimet e tjera të 'jakës së bardhë', mashtrimi kryhet gjithmonë kundër një pale të jashtme.
 - C. Krimi i 'jakës së bardhë' zakonisht kryhet për të mirën e një organizate, ndërsa nga mashtrimi përfiton një individ.
 - D. Krimi i 'jakës së bardhë' zakonisht kryhet nga të huajt në dëm të një organizate, ndërsa mashtrimi kryhet nga persona të brendshëm për të përfituar nga organizata.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

6. Drejtori i auditimit të një kompani të madhe prodhuese po konsideron rishikimin e statutit të departamentit të auditimit në lidhje me minimumin e kualifikimit arsimor dhe të përvojës së kërkuar. Drejtori i auditimit dëshiron që të i gjithë personeli i auditimit të kenë trajnim të specializuar në kontabilitet dhe një çertifikim profesional të auditimit siç është Auditori i Brendshëm i Çertifikuar (ABC) ose Kontabilisti i Çertifikuar (KC). Një nga disavantazhet e imponimit të kësaj kërkesë do të ishte:
- A. Politika mund të ndikojë negativisht në aftësinë e departamentit për të kryer ekzaminime cilësore të sistemeve financiare dhe të kontabilitetit të kompanisë.
 - B. Politika nuk do të promovonte profesionalizmin e departamentit.
 - C. Politika do të parandalonte departamentin nga përdorimi i konsulentëve të jashtëm kur departamenti nuk ka aftësitë dhe njohuritë e kërkuara në situata të caktuara të auditimit.
 - D. Politika mund të kufizojë gamën e aktiviteteve që mund të auditohen nga departamenti për shkak të ekspertizës dhe formimit të ngushtë të departamentit.**
7. Standardet e IIA deklarojnë se auditorët e brendshëm janë përgjegjës për vazhdimin e edukimit në mënyrë që të ruajnë aftësinë e tyre. Cila nga opsionet e mëposhtme është e saktë në lidhje me kërkesat për edukim të vazhdueshëm të auditorit të brendshëm praktikues?
- A. Auditorëve të brendshëm u kërkohet të ndjekin 40 orë edukim të vazhdueshëm profesional çdo vit dhe minimumi 120 orë gjatë një periudhe tre vjeçare.
 - B. Auditorët e Brendshëm të Çertifikuar kanë kërkesa zyrtare që duhet të plotësohen për të vazhduar si ABC.**
 - C. Pjesëmarrja, si oficer ose anëtar i komisionit, në takimet zyrtare të Institutit të Auditorëve të Brendshëm nuk plotëson kriterin e edukimit të vazhdueshëm profesional.
 - D. Programet e brendshme përmbushin kërkesat e vazhdueshme të edukimit profesional vetëm nëse ato janë miratuar nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm.
8. Shkathtësitë e komunikimit janë të rëndësishme për auditorët e brendshëm. Sipas standardeve, auditori duhet të jetë në gjendje të transmetojë në mënyrë efektive të gjitha të mëposhtmet tek i audituari përveç:
- A. Objektivave të auditimit të hartuara për një entitet specifik të auditueshëm.
 - B. Vlerësimet e auditimit bazuar në një sondazh paraprak të një subjekti të auditueshëm.
 - C. Vlerësimin të rrezikut të përdorur në zgjedhjen e fushës së auditimit.**
 - D. Rekomandimeve që gjenerohen në lidhje me një entitet specifik të auditueshëm.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

9. Ndërsa po planifikohej një auditim i veçantë në një fushë me rrezik të lartë, drejtori i auditimit përcakton që personeli i disponueshëm nuk ka aftësitë e nevojshme për të kryer detyrën. Mënyra më e mirë e veprimit në përputhje me standardet e planifikimit të auditimit do të ishte:
- A. Mos kryeni auditimin, pasi aftësitë e nevojshme nuk janë të disponueshme.
 - B. Përdorni auditimin si një mundësi trajnimi dhe lini auditorët të mësojnë ndërsa kryhet auditimi.
 - C. Merrni parasysh përdorimin e burimeve të jashtme për të plotësuar njohuritë, aftësitë dhe disiplinat e nevojshme dhe për të përfunduar detyrën.**
 - D. Kryeni auditimin, por kufizoni fushëveprimin në pjesën e mungesës së aftësive.
10. Sipas standardeve të IIA, auditorët e brendshëm duhet të jenë objektivë në kryerjen e auditimeve. Supozoni se drejtori i auditimit ka marrë një bonus vjetor si pjesë e pakos së kompensimit individual. Bonusi mund të dëmtojë objektivitetin e drejtorit të auditimit nëse:
- A. Bonusi administrohet nga bordi i drejtorëve ose komiteti i administrimit të pagave për auditorët.
 - B. Bonusi bazohet në rikuperimet monetare ose kursimet e rekomanduara në të ardhmen si rezultat i auditimeve.**
 - C. Qëllimi i punës së auditimit të brendshëm është rishikimi i kontrollit sesa i bilanceve të llogarive.
 - D. Të gjitha sa më sipër.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

11. Një departament i auditimit të brendshëm aktualisht po i nënshtrohet rishikimit të parë të sigurimit të jashtëm të cilësisë që nga formimi i tij tre vjet më parë. Nga intervistat me disa nga auditorët e stafit, ekipi shqyrtues informohet për aktivitete të caktuara të auditorit që kanë ndodhur gjatë vitit të kaluar. Cila nga aktivitetet e mëposhtme mund të ndikojë në vlerësimin e objektivitetit të departamentit të auditimit të brendshëm nga ekipi i rishikimit të sigurimit të cilësisë?
- A. Një auditor i brendshëm i tha ekipit shqyrtues se gjatë auditimit të pagave, menaxheri i pagave i propozoi atij një ofertë pune. Menaxheri tregoi se po kërkonte një kontabilist për të përgatitur pasqyrat financiare për biznesin e tij me kohë të pjeshme. Auditori i brendshëm ra dakord për të ofruar këtë shërbim për një tarifë të reduktuar jashtë orarit të punës.**
 - B. Gjatë auditimit të një kompanie ndërtimore e cila merrej me ndërtimin e zyrave shtesë të një korporate, Zëvendës menaxheri i dha auditorit një gotë përkujtimor me logon e kompanisë. Këto gota i'u shpërndanë të gjithë punonjësve të pranishëm në ceremoninë e themelimit.
 - C. Pas shqyrtimit të instalimit të një sistemi të përpunimit të të dhënave, auditori bëri rekomandime mbi standardet e kontrollit. Tre muaj pas përfundimit të auditimit, i audituari kërkoi që auditori të rishikojë procedurat e caktuara për përshtatshmëri. Auditori ra dakord dhe kreu këtë rishikim.
 - D. U kërkua pjesëmarrja e një auditori në një task forcë për të zvogëluar humbjet e inventarit të kompanisë nga vjedhjet dhe dëmtimet. Kjo është detyra e parë këshilluese e ndërmarrë nga departamenti i auditimit. Roli i auditorit është të këshillojë task forcën për teknikat e duhura të kontrollit.
12. Duke pasur parasysh që është marrë vendim për reduktimin e kostove të auditimeve dhe mungesën e burimeve të auditimit të brendshëm, menaxheri i auditimit gjithashtu vendosi që kontrollet pasuese nuk ishin të nevojshme. Menaxheri arsyetoi se kursimet e kostos duhet të jenë të mjaftueshme për të motivuar të audituarin për të zbatuar rekomandimet e auditorit. Prandaj, kontrollet pasuese nuk ishin planifikuar si pjesë e rregullt e planit të auditimit. A shkelen standardet nga vendimi i menaxherit të auditimit?
- A. Jo. Standardet nuk specifikojnë nëse është e nevojshme kryerja e kontrolleve pasuese.
 - B. Po. Standardet kërkojnë që auditorët të përcaktojnë nëse i audituari i ka zbatuar në mënyrë të përshtatshme të gjitha rekomandimet e auditorit.
 - C. Po. Mungesa e burimeve nuk është një arsye e mjaftueshme për të larguar kontrollet pasuese.**
 - D. Jo. Kur ka dëshmi të motivimit të mjaftueshëm nga i audituari, nuk ka nevojë për veprim vijues.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

13. Është vërtetuar që një statut i auditimit të brendshëm është një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë pozitivisht në pavarësinë e departamentit të auditimit të brendshëm. Standardet e IIA ndihmojnë në qartësimin e natyrës së statudit duke ofruar udhëzime për përmbajtjen e statudit. Cila nga opsionet e mëposhtme NUK sugjerohet në Standarde si pjesë e statudit?
- A. E drejta e çasjes së departamentit në regjistrat brenda organizatës.
 - B. Shtrirja e aktiviteteve të auditimit të brendshëm.
 - C. Kohëzgjatja e mandatit për drejtorin e auditimit të brendshëm.**
 - D. Çasja e departamentit në personel brenda organizatës.
14. Menaxhmenti i ka kërkuar departamentit të auditimit të kryejë një auditim të zbatimit të kodit të sjelljes të kompanisë të zhvilluar së fundmi. Gjatë përgatitjes për auditim, auditori rishikon kodin e sjelljes të sapo zhvilluar dhe e krahason atë me kodin e sjelljes të disa kompanive konkurente dhe konkludon se kodi i sapo zhvilluar ka mangësi të mëdha. Bazuar në këtë përfundim, auditori duhet të:
- A. Planifikoj një auditim për zbatimin e kodit të sjelljes së menaxhmentit dhe gjithashtu për pajtueshmërinë me "praktikat më të mira" nga kodet e tjera pasi që kjo përfaqëson kriteret më të mira në dispozicion.
 - B. Raportoni natyrën e mangësive në një raport zyrtar tek menaxhmenti.**
 - C. Informoni menaxhmentin për problemet me kodin ekzistues dhe raportoni se do të ishte e papërshtatshme të kryhet një auditim derisa të rishikohet kodi për të përfshirë "praktikat më të mira" nga industria.
 - D. Kryeni auditimin siç kërkohet nga menaxhmenti, duke raportuar vetëm mospërputhje me kodin.
15. Standardet e IIA kërkojnë që drejtori i auditimit të kërkojë miratimin e menaxhmentit dhe pranimin nga bordi të një statuti zyrtar të shkruar për departamentin e auditimit të brendshëm. Qëllimi i këtij statuti zyrtar është që:
- A. Mbron departamentin e auditimit të brendshëm nga ndikimi i jashtëm i padrejtë.
 - B. Përcakton qëllimin, autoritetin dhe përgjegjësinë e departamentit të auditimit të brendshëm.**
 - C. Përcakton qartë marrëdhëniet midis auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.
 - D. Vendos statusin e drejtorit si një staf ekzekutiv.
16. Kriteret kryesore për përcaktimin e mjaftueshmërisë së dokumenteve të punës mund të gjenden në:
- A. Standardet e IIA.**
 - B. Kodi i Etikës i IIA.
 - C. Udhëzime praktike.
 - D. Akti i Praktikave të Korrupsionit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

17. Bazuar në Standardet e IIA, programi i zhvillimit të stafit të një departamenti të auditimit të brendshëm do të jetë i mangët nëse punonjësit individualë:
- A. Janë deleguar një larmi të madhe detyrash për të kryer.
 - B. Pritet të analizojnë ngjarjet aktuale mbi një bazë të pavarur.
 - C. Janë caktuar në mbikëqyrës të ndryshëm për secilën punë.
 - D. Vlerësohen zyrtarisht një herë në dy vjet.**
18. Standardet e IIA kërkojnë politika dhe procedura të shkruara për të udhëzuar stafin e auditimit. Cila nga pohimet e mëposhtme NUK është e saktë në lidhje me këtë kërkesë?
- A. Forma dhe përmbajtja e politikave dhe procedurave të shkruara duhet të jenë të përshtatshme me madhësinë e departamentit.
 - B. Të gjitha departamentet e auditimit të brendshëm duhet të kenë një manual të detajuar të politikave dhe procedurave.**
 - C. Manualet zyrtare administrative dhe teknike të auditimit mund të mos jenë të nevojshme nga të gjitha departamentet e auditimit të brendshëm.
 - D. Një departament i vogël i auditimit të brendshëm mund të menaxhohet jozyrtarisht përmes mbikëqyrjes së ngushtë dhe memorandumëve të shkruara.
19. Një auditor i brendshëm i ri në profesion është duke përfunduar një raport të auditimit. Raporti përfundimtar duhet të nënshkruhet në mënyrë të përshtatshme nga:
- A. Auditori për shkak të një niveli më të lartë të njohurive të hollësishme të raportit.
 - B. Auditori dhe personi përgjegjës i departamentit që auditohet për të treguar rishikimin e raportit.
 - C. Drejtori ekzekutiv i auditimit.**
 - D. Kryetari i komitetit të auditimit të bordit të drejtorëve.
20. Cila nga opsionet e mëposhtme do të promovonte më mirë pavarësinë e funksionit të auditimit të brendshëm?
- A. Një sistem i kontrollit të cilësisë brenda funksionit të auditimit të brendshëm i krijuar për të siguruar përmbushjen e objektivave të departamentit.
 - B. Linja e drejtpërdrejtë e komunikimit në mes komitetit të auditimit dhe drejtorit ekzekutiv të auditimit.**
 - C. Një statut i shkruar që pasqyron konceptet e përfshira në Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm.
 - D. Përgjegjësitë e raportimit të drejtpërdrejtë tek zyrtari kryesor financiar i kompanisë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Mrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

21. Si pjesë e një programi të përgjithshëm të kontrollit të cilësisë, një firmë jo vetëm që inspekton mallrat e përfunduar dhe të gatshëm për shitje, por monitoron edhe produktet që kthehen dhe ankesat e konsumatorëve. Cili lloj i kontrolleve i përshkruan më së miri këto përpjekje?
- A. Kontrollat reaguese (feedback).**
 - B. Kontrollat parandaluese.
 - C. Kontrollat e prodhimit.
 - D. Kontrollat e stoqeve.
22. Kontrolli është përshkruar si një sistem i mbyllur i përbërë nga gjashtë elemente. Identifikoni njërin nga gjashtë elementet .
- A. Vendosja e standardeve të performancës.**
 - B. Sigurimi adekuat i dosjeve të të dhënave.
 - C. Miratimi i kartës së auditimit.
 - D. Themelimi i funksionit të auditimit të pavarur.
23. Cila nga kontrollet e të dhënave hyrëse (input controls) ose kontrolleve të modifikimit do të zbulonte lloje të caktuara të gabimeve brenda fushës së shumës së pagesës së një transaksioni:
- A. Numërimi i regjistrimeve.
 - B. Kontrolli echo.
 - C. Kontrollimi i shifrës.
 - D. Kontrollimi i limitit.**
24. Për t'u siguruar që mallrat e pranuar janë të njëjta me ato të paraqitura në faturën e blerjes, një sistem i kompjuterizuar duhet të:
- A. Harmonizojë fushat e zgjedhura të faturës së blerjes me mallrat e pranuar.**
 - B. Mbaj në kontroll vlerën totale të stoqeve.
 - C. Llogarit totalin e grumbulluar për çdo hyrje.
 - D. Përdorë kontrollin e shifrave në numrat e llogarisë.
25. Koncepti i kontrollit duhet të shihet si:
- A. Përbushje e një objektive.**
 - B. Kufizim i një operacioni.
 - C. Bllokim i një procesi.
 - D. Frenim i një personi.
26. Cili grup ka përgjegjësinë kryesore për krijimin, implementimin dhe monitorimin e kontrolleve adekuate gjatë regjistrimit të llogarive të arkëtueshme?
- A. Auditorët e jashtëm.
 - B. Stafi i llogarive të arkëtueshme.
 - C. Auditorët e brendshëm.
 - D. Menaxheri i kontabilitetit.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

27. Një auditor i ri është duke u informuar për llojet e ndryshme të auditimeve nga mbikëqyrësi i auditimit. Mbikëqyrësi thekson se disa fusha brenda organizatës janë më të vështira për t'u audituar, sepse kontrollat në përgjithësi nuk janë aq të përcaktuara qartë si në departamentet e tjera. Zgjidhni llojin e kontrollit që zakonisht është më i vështirë për t'u vlerësuar.
- A. **Operativ.**
 - B. Harduerik.
 - C. Kontabiliteti.
 - D. Siguria fizike.
28. Sipas raportit të COSO, plani i auditimit ndryshon kur:
- I. Rreziqet ndryshojnë.
 - II. Burimet e auditimit ndryshojnë.
 - III. Ndryshon Bordi.
 - IV. Politikat ndryshojnë.
- A. Vetëm I.
 - B. **I dhe II.**
 - C. III dhe IV.
 - D. I, II, III, IV.
29. Sipas Standardeve të IIA, cila nga të mëposhtmet përshkruan më së miri dy kategoritë e përgjithshme ose llojet e mashtrimeve që kanë të bëjnë me auditorët e brendshëm?
- A. Pagesat e pahijshme (dmth. mitot dhe ryshfetet) dhe mashtrimet tatimore.
 - B. **Mashtrimi i projektuar për të përfituar organizata dhe mashtrimi i kryer në dëm të organizatës.**
 - C. Pranimi i mitove ose ryshfeteve dhe kryerja e transaksioneve të paligjshme me palët e ndërlidhura.
 - D. Pranimi i shantazheve ose përvetësimi dhe keqpërdorimi i pasurisë.
30. Përdorimi mashtrues i kartelave të kreditit të korporatave do të minimizohej me cilin nga procedurat e mëposhtme të kontrollit të brendshëm?
- A. Krijimi i një politike korporative për lëshimin e kartave të kreditit për punonjësit e autorizuar.
 - B. Rishikimi i vlefshmërisë së kartës së kreditit në nivel ekzekutiv dhe operues në baza periodike.
 - C. Harmonizimi i gjendjes mujore të kredit kartës së korporatës me kopjet e dorëzuara të faturave të ngarkuara ndaj mbajtësit të kredit kartës.
 - D. **Subjektimi i tarifave të kartës së kreditit ndaj të njëjtave kontrole të shpenzimeve si ato të përdorura në formën e shpenzimeve të rregullta të kompanisë.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

31. Në mënyrë që auditorët e brendshëm të jenë në gjendje të njohin mashtrimin e mundshëm, ata duhet të jenë të vetëdijshëm për karakteristikat themelore të mashtrimit. Cila nga të mëposhtmet nuk është një karakteristikë e mashtrimit?
- A. Mashtrimi i qëllimshëm.
 - B. Marrja e përfitimit të padrejtë ose të pandershëm.
 - C. Kryerja e verprimit në dobi ose në dëm të organizatës.
 - D. Neglizhenca nga ana e menaxhmentit ekzekutiv.**
32. Një auditor po heton performancën e një divizioni me një rritje të pazakontë të shitjeve, marzhës bruto dhe fitimit. Nëse auditori vazhdon të dyshojë në regjistrimin mashtrues të transaksioneve për të rritur fitimet e raportuara, cili nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të jetë më pak efektiv?
- A. Marrja e stoqeve fizike.
 - B. Zhvillimi i një plani mujor të stoqeve dhe hetimi i luhatjeve të pazakonta duke iu referuar regjistrimeve të përhershme të stoqeve.**
 - C. Përgatitja e një plani mujor të luhatjeve të shitjeve dhe marzhës brutoj. Hetoni muajt me shitje dhe marzhë bruto jashtëzakonisht të lartë nëpërmjet shqyrtimit të mbështetjes për shitjet.
 - D. Kryerja e testeve të mbylljes së vitit në fund të vitit për shitjet dhe blerjet.
33. Më poshtë janë paraqitur faktet për një filial:
- I. Kompania filiale ka qenë në biznes për disa vite dhe ka gëzuar marzha të mira fitimi edhe pse ekonomia e përgjithshme ishte në recesion, e cila i preku konkurrentët.
 - II. Koeficienti i kapitalit të punës ka rënë nga një shifër e shëndetshme 3:1 në 0.9:1.
 - III. Shkalla e qarkullimit të stafit, për disa vite të fundit, ka përfshirë tre kontabilistë, dy mbikëqyrës të llogarive të arkëtueshme, katër mbikëqyrës të llogarive të pagueshme dhe një numër të stafit në pozita të tjera financiare.
 - IV. Politika e blerjes e korporatës kërkon tre oferta. Megjithatë, mbikëqyrësi i blerjeve në filial ka krijuar një politikë të prokurimit me burim të vetëm (me një ofertë) për të zvogëluar numrin e furnitorëve.
- Gjatë kryerjes së auditimit financiar të filiales, auditori i brendshëm do të:
- A. Nuk ka gjasa të zbulojë faktin në pikën I, II ose III.
 - B. Injorojë faktin në pikën II pasi që ekonomia e përgjithshme kishte rënie gjatë kësaj periudhe.
 - C. Konsideroj faktin në pikën III të jetë qarkullim normal i stafit, por do të jetë i shqetësuar për faktet në pikën II dhe IV si sinjale paralajmëruese të mashtrimit.
 - D. Konsideroj faktet në pikën I, II, III dhe IV si sinjale paralajmëruese të mashtrimit.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

34. Rroni dhe Joni kishin njohur njëri-tjetrin për shumë vite. Ata ishin bërë miq të mirë që në kolegji, ku të dy diplomuan në kontabilitet. Pas diplomimit, Rroni mori në mbikëqyrje biznesin e familjes nga babai i tij. Familja e tij kishte një biznes ushqimor për disa breza. Kur Joni kishte vështirësi në gjetjen e një pune, Rroni i ofroi atij punë në dyqanin e familjes. Joni dëshmoi të qenit një punonjës shumë i aftë. Ndërsa Joni demonstroi aftësitë e tij, Rroni filloi të delegonte gjithnjë e më shumë përgjegjësi ndaj tij. Pas një periudhe kohore, Joni po kryente të gjitha autorizimet dhe funksionet e përgjithshme të kontabilitetit për çeqet, paratë, stoqet, dokumentet, regjistrimet dhe harmonizimet e deklaratave bankare.
- I. Joni u konsiderua plotësisht i besueshëm dhe trajtoi të gjitha funksionet financiare. Askush nuk e kontrollonte punën e tij. Rroni vendosi të zgjerojë biznesin dhe hapi disa dyqane të reja.
 - II. Rroni trajtonte gjithmonë problemet më urgjente ... profesorët e tij të kolegjit e kishin quajtur "menaxher i krizës". Joni e ndihmonte me problemet kur punët e tjera të tij i lejonin kohë. Ndonëse ishte i suksesshëm në punë, Joni kishte vështirësi me problemet financiare personale.
 - III. Në fillim, shumat që Joni vodhi ishin të vogla. Ai as nuk u shqetësua për të bërë bilancin e llogarive. Por Joni u bë lakmitar. "Sa e lehtë është të marrësh para," tha ai. Ai ndjeu se ai ishte një anëtar kritik i ekipit të biznesit, dhe se ai kontribuoi shumë më shumë në suksesin e kompanisë sesa ishte përfaqësuar nga paga e tij.
 - IV. Do të duheshin dy ose tre vetë për të më zëvendësuar, ai shpesh mendonte për vetveten. Ndërsa shumat bëheshin çdo herë e më të mëdha, ai bëri bilancin e librave.
 - V. Për shkak të këtyre aktiviteteve, Joni ishte në gjendje të blinte një makinë të shtrenjtë dhe të merrte familjen e tij në disa udhëtime çdo vit.
 - VI. Ai gjithashtu u bashkua me një klub të shtrenjtë të vendit. Gjithsesi, gjërat ndryshonin në shtëpi. Familja e Jonit vuri re se shpesh ai ishte argumentues dhe në raste të tjera shumë në depresion.
 - VII. Mashtrimi vazhdoi për gjashtë vjet. Çdo vit biznesi performoi gjithnjë e më keq. Në vitin e kaluar dyqanet humbën mbi 200,000 €. Banka e Rronit kërkoi një auditim. Joni u rrëfye kur mendoi se auditorët kishin zbuluar përvetësimet e tij.

Kur diskutohen mashtrimet, shpesh janë identifikuar presionet, mundësitë dhe racionalizimet që shkaktojnë/lejojnë një keqbërës që të kryejë mashtrimin. Gjithashtu janë studiuar simptomat e mashtrimit.

Identifikoni faktorët e numëruar dhe të nënvizuar (nga skenari) si një nga simptomat, presionet, mundësitë ose racionalizimet e dhëna. Numri III "Vështirësitë me probleme financiare personale", është një shembull i një:

- A. Racionalizimi.
- B. Presioni të situatës.**
- C. Simptome të sjelljes.
- D. Mundësie për të kryer.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

35. Menaxhmenti i një kompanie të sigurimit të pasurive dhe shëndetit është i shqetësuar për efikasitetin dhe efektivitetin e aktiviteteve të përpunimit të dëmeve. Menaxhmenti ka dy shqetësime kryesore: (1) Disa kërkesa janë duke u paguar që nuk duhet të paguhen ose po paguhen në shuma më të mëdha se polica; dhe (2) shumë pretendues nuk po paguhen në kohë. Gjatë përgatitjes për një auditim të fushës, auditori i brendshëm vendos të kryejë një studim paraprak për të mbledhur më shumë informacion në lidhje me natyrën e përpunimit dhe problemet e mundshme.

Pas ndjekjes së hetimit, dy punonjës të dëmeve vërtetojnë pretendimet dhe tregojnë se ishte një plan i zhvilluar nga mbikëqyrësi dhe se atyre ju është bërë presion për të ndjekur skemën. Auditori vendos të marrë në pyetje mbikëqyrësin, i cili bëhet shumë armiqësor kur u përgjigjet pyetjeve të auditorit. Auditori duhet të:

- A. Tregoj që nëse mbikëqyrësi nuk do të bashkëpunojë, auditori do t'ia dorëzojë çështjen autoriteteve ligjore për hetime të mëtejshme.
- B. Tregoj se ky nuk është një auditim i mashtrimir dhe se qëllimi është të identifikojë natyrën e transaksioneve të përpunuara gabimisht dhe arsyen e problemeve të hasura. Theksoni që bashkëpunimi i mbikëqyrësit do të dokumentohet në dokumentet e punës.
- C. Përgjigjeni në një mënyrë të ngjashme dhe tregoni provat që auditori tashmë ka marrë. Bëni presion ndaj mbikëqyrësit për të rrëfyer mashtrimin dhe për të përmendur të tjerët të përfshirë në skemë.

D. Përkruaj qëllimin e intervistës dhe natyrën e provave të kërkuara. Inkurajoni mbikëqyrësin që të vazhdojë intervistën.

36. Kur kryeni intervista gjatë fazave të hershme të auditimit të brendshëm, është më efektive të:

- A. Kërkoni përgjigje specifike që mund të vlerësohen.
- B. Pyesni njerëzit për punët e tyre.**
- C. Bëni pyetje surprizë në lidhje me procedurat e përditshme.
- D. Përfitonin nga fakti që frika nga auditimi është një pjesë e rëndësishme e auditimit.

37. Teknikat e intervistimit përdoren shpesh nga auditorët e brendshëm. Kur merret parasysh përdorimi i mundshëm i teknikave të intervistimit për të mbledhur prova të auditimit, auditorët duhet të jenë të vetëdijshëm që ato intervista:

- A. Janë më objektive se pyetësorët në mbledhjen e të dhënave.
- B. Ofrojnë një format sistematik për të siguruar mbulimin e auditimit.
- C. Duhet të vërtetohen duke mbledhur të dhëna objektive.**
- D. Janë më të përshtatshme për arritjen e përfundimeve të auditimit.

38. Përdorimi i metodës së numrave të rastit për të zgjedhur një mostër të auditimit:

- A. Kërkohet për një plan të marrjes së mostrës në variabla.
- B. Ka të ngjarë të rezultojë në një mostër të paanshme.**
- C. Rezulton në një mostër përfaqësuese.
- D. Lejon auditorët të përdorin mostra më të vogla.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

39. Një auditor testoi një popullatë duke ekzaminuar 60 artikuj të përzgjedhur duke u bazuar në gjykim dhe gjeti një gabim. Kufizimi kryesor i mostrës së auditorit është pamundësia për të:
- A. Vlerësuar sasinë e rrezikut të marrjes së mostrave.**
 - B. Vlerësuar shumën e pranueshme të gabimit.
 - C. Projektuar shkallën e gabimit të popullsisë.
 - D. Përcaktuar nëse mostra është e rastësishme.
40. Marrja e mostrave statistikore do të ishte e përshtatshme për të vlerësuar vlerën e 3,000 artikujve të inventarit të një tregtari të pjesëve automobilistike, sepse marrja e mostrave statistikore është:
- A. E besueshme dhe objektive.**
 - B. E plotë
 - C. E plotë dhe e saktë.
 - D. E plotë dhe precize.
41. Një auditor i brendshëm dëshiron të përcaktojë nëse regjistrat e inventarit të përhershëm të mallrave të gatshme po azhurnohen siç duhet për prodhimin e përfunduar. Për ta arritur këtë qëllim, auditori gjurmon sasinë e inventarit dhe të dhënat e kostos nga raportet e prodhimit në regjistrat e përhershëm të inventarit, duke përdorur një madhësi të përshtatshme të mostrës bazuar në nivelin e besimit 95%, shkallën e vlerësuar të gabimit prej 4% dhe saktësinë e dëshiruar prej 2%. Nëse shkalla e gabimit në mostër është, siç pritej, 4%, dhe 2,000 raporte prodhimi u postuan në regjistrat e përhershëm të inventarit gjatë vitit, auditori mund të jetë i sigurt 95% se numri i postuar gabim ishte:
- A. Të paktën 100.
 - B. Të paktën 80.
 - C. Mes 60 dhe 140.
 - D. Mes 40 dhe 120.**
42. Mbikëqyrësi i departamentit të përpunimit të kërkesave për një firmë të sigurimeve shëndetësore zgjedh për auditim të gjitha kërkesat për kompensim të dëmeve të përpunuara në dy ditët e fundit nga një punonjës i veçantë. Nga kjo mostër, mbikëqyrësi mund të zhvillojë:
- A. Një pamje të përgjithshme përfaqësuese të punës së punonjësve për vitin.
 - B. Një përcaktim sasior të gabimit të mostrës.
 - C. Konkluzione në lidhje me korrektësinë e përpunimit për departamentin.
 - D. Të kuptuarit e detajeve të përfshira në detyrën e përpunimit.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

43. Për të audituar faturat e paguara gjatë vitit të kaluar, një auditor zgjedh dy muajt më të ngarkuar të vitit, të cilët zënë 60% të faturave. Pas një fillimi të rastësishëm, çdo e dhjeta faturë zgjidhet duke dhënë një shembull të 116 faturave. Kjo mostër mund të mos jetë e vlefshme sepse nuk është një:

- A. Mostër përfaqësuese.**
- B. Mostër e rastësishme.
- C. Mostër mjaft e madhe.
- D. Asnjë nga opsionet e mësipërm - mostra është e vlefshme.

44. Ndërsa kryente procedurat analitike në lidhje me një auditim të një agjencioni të shërbimeve sociale të një njësie qeveritare, auditori vuri në dukje se kishte një rritje jashtëzakonisht të madhe në pagesa për përfituesit individualë të cilët janë nën drejtimin e një punonjësi social të veçantë në agjenci.

Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të ishte procedura më e mirë për të hetuar këtë vëzhgim?

- A. Përdorni softuer të përgjithshëm të auditimit për të renditur pagesat për përfituesit nga punonjësi social. Pastaj renditni pagesat sipas adresave dhe emrave.**
- B. Zbatoni një strukturë testimi të integruar dhe monitoroni transaksionet gjatë gjithë vitit për të identifikuar artikuj të pazakontë.
- C. Zbatoni qasjen në fotografi dhe shënoni transaksionet që kanë të bëjnë me punonjës social të identifikuar me rritje jashtëzakonisht të mëdha në pagesa.
- D. Përdorni softuer të përgjithshëm të auditimit për të marrë një mostër të rastësishme të përfituesve dhe hetoni duke dërguar konfirmime të secili përfitues individual për të përcaktuar nëse ishin marrë pagesa të duhura.

45. Shumë kompani të shërbimeve publike operojnë sisteme komplekse të shërbimit ndaj klientit (CSS) për të menaxhuar funksionin e tyre të shërbimit ndaj klientit. CSS-të veprojnë online në internet, në kohë reale, i cili lejon që të dhënat e shërbimit të klientit të futen drejtpërdrejt në internet nga thirrjet telefonike të klientit. Cila nga teknikat e mëposhtme të auditimit të teknologjisë së informacionit i ofron auditorit aftësinë për të monitoruar vazhdimisht të dhënat e shërbimit ndaj klientit që mbliidhen nga thirrjet telefonike në CSS?

- A. Softuer i përgjithshëm i auditimit.
- B. Grafiket e kontrollit.
- C. Mbledhja e integruar e të dhënave të auditimit.**
- D. Struktura e integruar e provës (ITF).

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

46. Cila nga opsionet e mëposhtë është një procedurë e përshtatshme e auditimit që mund të përdoret për të testuar mjaftueshmërinë e kontrolleve të aplikimit mbi llogaritë e pagueshme të bazuara në kompjuter?
- A. Vëzhgimi i bibliotekës kompjuterike dhe zonës së operacioneve për të marrë dëshmi për të mbështetur një mendim në lidhje me sigurinë e të dhënave të llogarive të pagueshme.
 - B. Krahasimi manual i numrave të faturave të furnitorit me ato të listuara në listat e llogarive të pagueshme të krijuara nga kompjuteri për të vlerësuar efektivitetin e kontrolleve të sekuencave të bazuara në kompjuter.
 - C. Testimi i transaksioneve të blerjes duke përdorur një qasje të të dhënave test.**
 - D. Përdorimi i një pyetësoi të krijuar nga kompjuteri për të marrë informacion të besueshëm në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e futjes dhe azhurnimit të të dhënave të pagueshme nga personeli i menaxhimit kompjuterik të organizatës.
47. Gjatë një kontrolli operacional, një auditor krahason normën e qarkullimit të inventarit të një filiali me standardet e vendosura të industrisë për të:
- A. Vlerësuar saktësinë e raporteve të brendshme financiare të filialit.
 - B. Testuar kontrollet e filialit të dizajnuara për të ruajtur pasuritë.
 - C. Përcaktuar nëse filiali është në përputhje me procedurat e korporatave në lidhje me nivelet e inventarit.
 - D. Vlerësuar performancën e filialit dhe tregoni se ku mund të nevojitet punë shtesë e auditimit.**
48. Të dhënat e mbledhura në mbështetje të një përfundimi të auditimit mund të vlerësohen në një vazhdimësi të besueshmërisë. Forma më e besueshme e provave do të ishte një:
- A. Dokumenti i brendshëm i marrë nga i audituari.
 - B. Dokumenti i jashtëm i marrë direkt nga një burim i jashtëm.**
 - C. Dokumenti i brendshëm që i nënshtrohet procedurave rigoroze të rishikimit të brendshëm.
 - D. Dokumenti i brendshëm që është rishikuar nga një pale e jashtme.
49. Më poshtë janë cekur burime të mundshme të provave në lidhje me efektivitetin e programit të menaxhimit të cilësisë totale të divizionit (TQM). Supozoni se të gjitha krahasimet janë për periudha të ngjashme kohore dhe kohëzgjatje, dhe se artikujt aktualë krahasohen me artikuj të ngjashëm para implementimit të programit TQM. Provat më pak bindëse do të ishin krahasimi i:
- A. Moralit të punonjësve gjatë dy periudhave kohore.**
 - B. Kostot e skrapit dhe ripunimit gjatë dy periudhave kohore.
 - C. Kthimet e klientëve gjatë dy periudhave kohore.
 - D. Kostot e prodhimit dhe shpërndarjes për njësi gjatë dy periudhave kohore.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

50. Cila nga procedurat e mëposhtme do të siguronte provat më të mira të efektivitetit të një funksioni të dhënies së kredive?
- A. Vëzhgimi i procesit.
 - B. Rishikimi i trendit të shlyerjes së llogarive të arkëtueshmeve.**
 - C. Pyesni menaxherin e kredive për efektivitetin e funksionit.
 - D. Kontrolloni për evidenca të miratimit të kredisë në një shembull të porosive të klientëve.